



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PRIDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunes)

Nr./Br./No 2484 Nr. i faq./Br.str./No pg 20

Data/Datum/Date 22 / 7 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, nenit 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna dhe nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, Kryetari i Komunës është i obliguar që të mbaj së paku dy takime publike me qytetarë. Takimi i parë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e parë kurse takimi i dytë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e dytë të vitit.

Andaj, bazuar në obligimet ligjore që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe Rregullorja për transparencë në komuna, kryetari në bashkëpunim me Zyrën për Informim organizon Takimin e parë publik për punën në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.

Njoftimi për mbajtjen e takimit publik, ashtu siç prashihet në Udhëzimin administrativ për standardet minimale të konsultimit publik, u publikua në të dy gjuhët më: 9 qershor 2022, 14 ditë para mbajtjes së takimit publik në web faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, në Platformën qeveritare për konsultime publike si dhe në rrjetet sociale.

Janë njoftuar me kohë kryetarët e lagjeve dhe fshatrave, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të mediave.

Në këtë takim publik, në koordinim me kryetarin e komunës kemi caktuar një rend dite, si vijon:

- PREZANTIMI I RAPORTIT GJASHTË MUJOR TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
- INFORMIM RRETH PROJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT
- PYETJE DHE PËRGJIGJE

Sipas nenit 10, pika 7 e Rregullores për transparencë në komuna, nëse parashtrohet ndonjë pyetje për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtuesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së takimit.

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

Për takimin publik do të mbahet procesverbal, i cili do të përmbaj të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre si dhe pyetjet dhe përgjigjet e dhëna, i cili do të publikohet ne web faqen zyrtare të Komunës.

Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe përgjigjet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga data e mbajtjes së takimit e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa, i cili analizon çdo propozim të dhënë në takim dhe bën rekomandimet e nevojshme të cilat ja propozon Kuvendit të Komunës për takimin e ardhshëm.

Tani pa humbur kohë ftoj Kryetarin e Komunës ta bëj prezantimin e Raportit 6-mujor të punës si dhe Informatën rreth projekteve dhe aktiviteteve në komunën e Rahovecit.

Pas prezantimit nga kryetari i komunës, ju mund të shtroni pyetje dhe kërkesa për çështjet që ju interesojnë.



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

TAKIMI PUBLIK

Takimi publik filloi në orën 13:00.

Të pranishëm në këtë takim ishin: Smajl Latifi, kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, kryetarë të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, zyrtarë komunal, përfaqësues të mediave, OJQ.

Smajl Latifi: Përshëndetje dhe mirëdita të gjithëve, qytetarë të pranishëm, përfaqësues të shoqërisë civile, fshatrave dhe lagjeve urbane, drejtorë të shkollave, përfaqësues të mediave, OSBE, të gjithë ju të pranishëm. Ju faleminderit për përgjigjen pozitive që ja keni bërë ftesës për këtë takim publik të gjashtë mujorit të parë të paraqitjes së informacioneve, përkatësisht raportit gjashtëmujor të punës për këtë vit. Unë pa humbur kohë po e bëj një paraqitje të raportit gjashtë mujor të punës, këtu me mua janë edhe anëtarët e qeverisjes komunale, nënkryetari drejtorët e drejtorive dhe stafi i zyrës së kryetarit. Pjesa e parë e raportit përmban një fjalë hyrëse, sa për informacionin tuaj raporti është i publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit. Pjesa e dytë, ose vazhdojmë tutje prioritetet e programit qeverisës, janë zotimet e kryetarit të komunës, janë prioritetet kryesore për vitin 2022, janë poashtu edhe synimet të cilat ne përpiqemi ti jetësojmë në vitin 2022, janë sfidat kryesore të cilat e karakterizojnë vitin 2022, përkatësisht gjashtë mujorin e parë të këtij viti. Pastaj, shkojmë me pjesë konkrete të raportit, Zyra Ligjore është pjesë e zyrës së kryetarit të komunës, e cila ka raportuar për aktivitetet në gjashtë mujorin, objektivat të cilat i ka arritur, e kemi raportin e Njesisë së Personelit, e cila është zyre e kryetarit të komunës, ku flet për aktivitetet dhe ka të dhëna statistikore që flasin për gjithë aktivitetin që ka zhvilluar zyra e personelit. Janë edhe aktivitetet e komisionit diciplinor, vijueshmëria në punë, plani individual i personelit, administrimi i programeve elektronike etj. Kemi raportin gjashtë mujor të Zyrës së Prokurimit, është zyre që i subkoordinohet kryetarit të komunës, flitet për aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe raportuese. Është edhe raporti i zyrës për informim dhe marrëdhënie me publikun, tregon edhe për të arriturat dhe komunikimet që i ka pas kjo zyrë, qoftë me qytetarët qoftë edhe me institucionet tjera, qoftë edhe me mediat. Është edhe raporti i Njesisë së Auditimit

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

të Brendshëm, po ashtu është edhe zyre e kryetarit të komunës, e cila tregon për aktivitetet e tyre, cilat drejtori i kanë audituar. Kemi edhe raportin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, edhe këtu flitet për angazhimet, aktivitetet, për sfidat për të arriturat. Kemi edhe raportin e punës të Njesisë komunale për të drejtat e njeriut, aktivitetet të cilat janë zhvilluar në periudhën janar-qershor. Kemi raportin e zyrës për integritet Evropian, për barazi gjinore, raportin e zyrës ose sektorit për lektorim. Kemi edhe raportin ose raportet që janë mujore e që janë të paraqitura në kuadër të zyrës për përfaqësime ligjore, ose avokaturës komunale dhe po ashtu shkojmë tash te raportet të cilat i kanë secila drejtori, drejtoria e Administratës e cila i ka aktivitetet e gjendjes civile, sektori i teknologjisë informative, sektori për punë të kuvendit dhe komiteteve, sektori për logjistikë dhe mirëmbajtje të objekteve, qendra për shërbime me qytetarë. Kemi raportin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe ky raport e paraqet buxhetin për vitin 2022, si është ndarja e buxhetit në kategori buxhetore, sa janë subvencione, sa ka investime kapitale, sa ka mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, dhe po ashtu të hyrat vetanake. Kemi edhe tabelat këtu ku janë të paraqitura cila është ecuria e të hyrave vetanake, sektori i tatimit në pronë, kemi edhe angazhimet e kësaj drejtorie përgjatë kësaj periudhe gjashtë mujore. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, po ashtu e ka raportin e aktiviteteve të zhvilluara, sfidat, arritjet në këtë periudhë gjashtë mujore, përshkruhet ecuria e projekteve kapitale, sektori për punë sociale, flitet për aktivitetet të cilat zhvillohen aty. Drejtoria për Arsimit po ashtu e ka raportin e vet dhe të gjitha aktivitetet të cilat janë zhvilluar, sfidat dhe arritjet e kësaj drejtorie, është raport pak më i gjatë i kësaj drejtorie. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, janë aktivitetet të cilat janë kryer, ose janë në proces, thekset kryesore të arritjeve, sfidave dhe ngecjeve në këtë drejtori. Kemi raportin e drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, gjithashtu dhe sektorët e saj të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj gjashtë mujori, projektet dhe investimet kapitale, drejtorinë e Shërbimeve Publike, aktivitetet të cilat kanë ndodhur, është ndarë raporti në dy periudha, janar, shkurt, mars dhe prill, maj, qershor. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, po ashtu e ka raportin e vet, aktivitetet, theksin kryesor që e ka karakterizuar këtë gjashtëmujor. Po ashtu një pjesë e raportit

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

të kësaj drejtorie paraqet raportin e pagesave direkte ose subvencioneve, ditë më herët veçse kanë përfunduar aplikimet, sfidat kryesore të cilat i ka pasur kjo drejtori dhe bujku në veçanti, në këtë fazë, lehtësirat të cilat iu ka ofruar komuna e Rahovecit. Po ashtu jemi në pritje të realizimit të pagesave direkte nga ana e qeverisë, kemi edhe pjesën e investimeve kapitale, po ashtu edhe të pajisjeve bujqësore. Kemi raportin e drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, aktivitetet e kësaj drejtorie të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, numrin e lëndëve të cilat janë trajtuar dhe të hyrat vetanake, shërbimet të cilat i ka ofru kjo drejtori. Po ashtu kemi raportin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, të gjitha aktivitetet të cilat kjo drejtori i ka kryer për secilin muaj. Drejtoria për Punë Inspektuese, të gjitha veprimet të cilat janë marrë, gjobat mandatorë, llojet e inspektimeve dhe të hyrat të cilat kanë ardhur nga veprimet e inspektoratit të komunës. Në përfundim të këtij raporti e kemi pjesën ku ne presim vërejtje, këshilla, ide, sfidime nga të pranishmit sa i përket raportit. Sa për informacionin tuaj, ne kemi mbajtur 34 takime publike në periudhën maj—qershor, në cdo vendbanim të komunës së Rahovecit, me grupe të interesit, si me të rinjt, me shoqatën e pavarur të gruas, kemi mbajtur takim me OJQ me bisneze, me drejtor të shkollave edhe me grupe tjera të interesit, të cilat kanë qenë ne planin e punës të zyrës për informim.

Tash më lejoni në pika të shkurtra tju informoj rreth aktiviteteve të cilat i kemi kryer gjatë këtij gjashtë mujori, të përmbledhura në hapa konkrete gjatë këtij gjashtë mujori. Edhe këtu i kemi zotimet, programin qeverisës, prioritetet e këtij viti, premtimet të cilat janë dhënë gjatë dhënë gjatë fushatës parazgjedhore. Në pjesën tjetër i kemi të paraqitura me fotografi të gjitha aktivitetet të cilat ne kemi menduar që janë të rëndësishme me i nda me publikun dhe me qytetarët, për periudhën janar-qershor, pothuajse secila drejtori, aktivitetet e kryetarit dhe ekipit të tij të ilustruara dhe me fotografi. Unë nuk po po ju marr kohë sepse po dua me ju kalu fjalën juve shpejt, tash po dua me ju tregu që nëse për vitin 2020 ishim komuna e 5 në indexin e transparencës, sot jemi në vendin e dytë, nëse për vitin 2019 ishim komuna e dytë në Grantin e Performacës, për vitin 2020 jemi komuna e parë. Granti i performancës është 1 148 890 euro. Ne si komunë kemi shënuar rritje

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

në transparencë komunale, kemi shënuar progres dhe tash jemi ose të parët ose të dytë në matjet që i bëjnë ose KDI ose organizatat tjera monitoruese me instrumente të cilat i kanë në planet e tyre. Tash presim edhe transparimetrin, presim rezultat sepse për 3 vjet jemi komuna e parë, ne këto arritje të komunës së Rahovecit, këto lajme të mira të komunës së Rahovecit, patjetër që janë rezultat i komunikimit i angazhimit edhe i bashkëpunimit të mirë i të gjithë zyrtarëve të komunës së Rahovecit, padyshim këto na japin me kuptu që edhe tutje duhet të vazhdojmë që ta kemi një imazh më të mirë që në komunën e Rahovecit qeverisët mirë dhe pa korrupsion, në mënyrë transparente dhe qeverisja është në një shkallë të mirë të performancës komunale. Shpresoj që këto lajme të mira do ti shërbejnë qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe në frymën e këtij takimi të parë për gjashtë mujorin jemi në hap për lajme të mira për komunën tonë. Faleminderit shumë.


Blerta Gashi- Të nderuar të pranishëm fjala është për ju, kushdo që keni pyetje vetëm prezantohuni për shkak të procesverbalit. A ka dikush që dëshiron ta marrë fjalën.

Smajl Latifi-Fjala është e juaja, kushdo që keni dëshirë.

Teki Mustafa-Përshëndetje. Kam një pyetje jashtë këtij gjashtë mujori, sepse punët që janë kry janë të mrekullueshme, por, desha me ju pyet për Zonën Ekonomike, deri ku kanë shkuar punimet dhe ndërtesa për inovacion dhe muzikë, këto dyja më interesojnë.

Elona Spahiu-Unë nuk kam ndonjë pyetje veçse desha me ju falënderu që e keni vendos rininë e Rahovecit prioritet.

Murat Kryeziu- Xërxë-Desha me ju përshëndet kryetar juve dhe stafin tuaj komunal, unë i kam dy pyetje të shkurtra. Gjatë këtij gjashtë mujori, a ka lëviz diçka rreth çerdhes së fëmijëve dhe rreth projektit të shkollës në Xërxë.



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

Kujtim Sopjani, fshati Dobidol-Vec desha me ju përshëndet kryetar dhe me ju falënderu për projektet e fshatit Dobidol, poashtu presim dhe projektet tjera me u realizu.

Kryetari- Ju falënderoj shumë për pyetjet. Teki Mustafa ka pyet për Zonën Ekonomike. Parku Industrial, sipas planeve të ministrisë dhe sipas modeleve dhe formave të cilat janë aplikuar, me sipërfaqe rreth 35 hektar e 80 ari, është bahskëfinancim i komunës së Rahovecit dhe qeverisë, procedurat u zhvillon ministria, projekti kryesor është në duart tona, pra ndërtimi i infrastrukturës dhe përgatitja e plotë e Parkut Industrial për aftësim dhe vendosje të bizneseve është 2 780 000 euro. Komunës së Rahovecit, sipas udhëzimit i takojnë 150 000 euro mi dhënë ndër vite, ndërsa pjesa tjetër i mbetet ministrisë, fatkeqësisht ende nuk kemi hapa konkret në këtë drejtim. Në takimin që kam pasur me ministren Rozeta Hajdari, ka thënë që ministri i financave nuk po don me marr hapa konkret përderisa ka obligime për disa parqe ose zona ekonomike të cilat janë nëpër Kosovë e që sipas saj ende nuk janë paguar, pra, pa i kry ato obligime nuk po mundemi me nis zona tjera ekonomike, e që zona jonë është e para. A do të ketë zhvillime këtë vit, nuk e di sepse kemi ngecje të përgjithshme në investime publike nëpër Kosovë, mbase është faktor rritja e madhe e çmimeve. E di që një buxhet është ndarë për zona industriale, e ne kemi shpresuar shumë që ne si Rahovec të kemi hisen tonë, por, fatkeqësisht nuk ka lëvizje konkrete në atë drejtim. E që tia bëjmë me dije edhe një herë qytetarëve sepse u bë shumë zhurmë për zonën ekonomike, ne nuk kemi të drejtë sipas raportit që e kemi ndërtu, që të bëjmë investime të njëanshme, kritere që kanë kërkuar me i kry ne kanë qenë rrethimi i zonës ekonomike, që e kemi kry edhe licencimi i zonës që ka ndodh, madje njëri ndër kriteret për licencimin e zonës ka qenë edhe rrethimi i zonës me atë murin që është rrethuar, edhe tash topi është në duar të ministrisë, e që nëse është e gatshme me luajt ne jemi të gatshëm që si bashkëfinancues me kry pjesën tonë bashkë me ministrinë.

Qendra për Kulturë, Arte dhe Inovacion, një objekt i cili ka qarkulluar nëpër media. Ne e kemi projektin ideor dhe projektuesi ka marrë përsipër me e bo edhe projektin kryesor. Ne jemi të interesuar me realizu, galerinë e arteve, shkollën e muzikës, të përshtatshme për koncerte dhe

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

aktivitete tjera, objekt ky që ndoshta sdo të kishim nevojë më për qendrën e kulturës Mensur Zyberaj, sepse ky objekt i përmban të gjitha kërkesat dhe i plotëson nevojat edhe të shkollës së muzikës edhe të galerisë së arteve edhe të sallës së përshtatshme për aktivitete dhe koncerte. Ne e kemi cilësuar si Qendra për kulturë, arte dhe inovacion, e kemi të buxhetuar, jo me një shumë simbolike, ndoshta shkon rreth 3 milion euro ky projekt qysh është paraparë nga projektuesi.

Murat Kryeziu, kryetar i fshatit Xërxë- ka ngritur çështjen e ecurisë së çerdhes së fshatit Xërxë dhe objektin e ri të shkollës në Xërxë. Operatorët në çerdhen e fëmijëve janë duke punuar këto ditë, është vonuar pak si proces, unë besoj që në shtator, nëse nuk do të kemi vonesa, do të gjejmë modalitete për me funksionalizim edhe çerdhen e fëmijëve në Xërxë edhe në Krushë dhe në Ratkoc. Sfidën kryesore në funksionalizim e kemi stafin, nuk dijmë se si do të jetë modeli i funksionimit të çerdhes pa mungesë të stafit. Ne i kemi disa forma të cilat i aplikojmë në çerdhen e fëmijëve Tulipanët në Rahovec, por, nuk e di a do të kemi mundësi me i apliko këto forma në plotësimin e stafit të çerdheve të fëmijëve. Sa i takon objektit të shkollës, ne i kemi angazhu hartimin e projektit dhe sipas planit të prokurimit, diku në korrik ne do ta hapim ofertën për prokurim edhe këtu edhe në aneksin e shkollës në Ratkoc dhe projekte të tjera të cilat i kemi planifikuar. Kujtim Sopjani ishte edhe falënderues mirëpo ne kemi edhe projekte tjera edhe për Dobidolin edhe për cdo lokalitet të komunës së Rahovecit. Ne kemi jashtëzakonisht kontrata që jemi duke punuar edhe duke u përballuar me ngecje tjera, edhe sa i përket rritjes së çmimeve sepse operatorët ende po ngurrojnë të kthehen në punishtet e veta, sidomos ato operatorë të cilët kanë lidhur kontrata me komunën e Rahovecit para rritjes së çmimeve, kemi jashtëzakonisht shumë kontrata, por, sfidën kryesore e kemi rritjen e çmimeve, qoftë edhe operatorët po ngurrojnë, ne spo mund ti obligojmë përfundimisht me u rikthyer në punishte sepse të gjitha kalkulimet na thonë që ata mundën me punu me humbje dhe kjo i bjen një farë apeli me i dëmtu ata dhe me i dërgu pashmangshëm drejt falimentimit, por, kjo situatë nuk është vetëm në komunën tonë, është në shkallë republike, jemi në pritje edhe operatorët edhe ne që të mbulohen humbjet potenciale, të cilat i kanë operatorët të

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

të lidhet me këtë çmim por se vlera e zbatimit të projektit mund të jetë kjo. Ne jemi në pritje të lidhjes së kontratës për sheshin e qytetit, jo sheshin qendror, por, sheshin e qytetit, aty te xhamia, besoj që është një projekt i madh, jemi në pritje të funksionalizimit të tregut të rrushit, pra do të ketë elemente që ti ngjaj një tregu modern të rrushit, ne vendin ku mbahet Hardh festi, poashtu do të ketë dhe një qendër për magazinimin apo ruajtjen e produkteve, na ka ndihmuar poashtu edhe kuvendi komunal me miratimin e vendimin dhe një pjesë të grantit të performancës e kemi ndarë edhe për atë qendër.

Jam i vetëdijshëm që kemi probleme me ujë të pijshëm në Senoc, jam i vetëdijshëm poashtu që kemi probleme me ujin e pijshëm edhe në Zoqisht, Optrushë dhe Hoçë e Madhe. KRU Gjakova ka projekt për Senocin përfshin dhe Drenocin edhe Pastaselin, poashtu kemi edhe një projekt që përfshin Lagjen e Epërme, Optrushën, Zoqishtin dhe Hoçën e Madhe. Po ju them publikisht që nuk kemi të drejt të zhvillojmë procedura prokurimi për ujin e pijshëm, sidomos, sigurimin e ujit të pijshëm nga Radoniqi, sepse sipas ligjit për ndërmarrjet publike, ata i iniciojnë procedurat e prokurimit, kurse ne kemi hy në partneritet duke ndërtu marrëdhënie me KRU Gjakovën, me këtë rast 51 % i japin mjetet ata kurse ne 49%, me këtë rast ata i hapin procedurat, kurse ne i financojmë me pjesën e të hyrave që na sipas memorandumit të bashkëpunimit. Pra, në momentin që ata do të jenë të gatshëm, ne do të gjejmë mundësi me e kry pjesën e detyrës që neve na takon si Komunë.

Daut Krasniqi-Desha me pyet rreth ndriçimit publik, e pash një ditë kalova andej ka Brestoci, pash duke punuar, cka do të bëhet me ndriçimin publik andej ka ana jonë.

Smajl Latifi- Po Daut, faleminderit, mëzi kemi arritur me i bind operatorët ekonomik të ndriçimit me ju kthi punës. Tash janë duke punuar në Brestoc, Hoçë dhe Nagac sepse e ka atë vijë, por, besoni po punon me dy punëtorë. Ne e kemi ftu për zgjerimin e rrjetit me 3 punëtor edhe 3 me ndriçim ajror, por, nuk po mundet. Nëse do të kemi më shumë punëtor, ne do ta përmbushim akoma më shpejt kontratën. Sepse ne kontratën e kemi lidhur në 2020, e sot kur jemi në 2022 jemi

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

DËSHMI NGA TAKIMI I PARË PUBLIK

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraovac/Municipality of Rahovec

Në mbledhje të caktuar nga Komiteti i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në bazë të nenit 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës: 29.01.2017, nën 10 pika 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në korrupsion dhe nën 7 të Rregullores Komonale për Transparencë NR.03-2019, Kryetari i Komunës së bashkëpunon me Zyrtin për Informim, bën:

NJOFTIMIN
për
TAKIMIN E PARË PUBLIK TË KRYETARIT

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Samir Latifi organizon takim të parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) muajt e parë të vitit 2022.

Takimi publik me qytetarë do të mbahet në datë: 23.06.2022 (e enjte), në orën 13:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec. Në këtë takim do të kenë mundësi të ngjeshni për punën e qeverisë komonale në gjashtë (6) muajt e parë të vitit 2022 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Pu atëherë qytetarët pyetje dhe komentet e tyre do të kenë mundësi të bëjnë në Komunë për të gjitha temat të cilat tyre ju interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri në datë: 23.06.2022 në ora 16:00, në email: latifi.samir@ra-ov.net dhe bieta.cashi@ra-ov.net

Jeni të mirëpritur!

REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECIT
Opština Oraovac



**PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË
GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022**



**PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË
GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022**



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN NË
GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

Rahovec, 25.6.2022

Blerta Gashi



Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve të publikave dhe dëgjimeve publike



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë
mujorin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Yllgipe	Kryeriu	Asambleiste	043/404340	[Signature]	yllgipe3@kstrm.com
2	Donjeta	Vuqeterna	Koordinator	044-68819	[Signature]	donjeta.vuqeterna@gmail.com
3	Maliq	Jetahy	Deput	044-366-50	[Signature]	maliqjetahy@outlook.com
4	Naim	Kafexhiu	Deput	044-200-70	[Signature]	naim.kafexhiu@hotmail.com
5	GEZIM	DEER	Deput	045-900-60	[Signature]	
6	HASAN	PERRONI			[Signature]	
7	DASHAMIR	MORIND			[Signature]	
8	MUSTAFA	HOTI	DEPUT	044204072	[Signature]	mustafahoti59@hotmail.com
9	Mahmut	DURAKU	Koordinator i cështjeve	044-230-507	[Signature]	eng_duraku@hotmail.com
10	Malsor	Arllati			[Signature]	
11	FERIT	THAGI	Asambleist		[Signature]	
12	Kulzim	Kostali	Scholar	044207615	[Signature]	
13	LENDRI	MORIND		044-65051	[Signature]	
14	DURIM	GASHI	Futbollist	044-705770	[Signature]	
15	Qendrim	THAGI	Futbollist	043114423	[Signature]	
16	Xhahit	Thajrullaj	Asambleist	04581185	[Signature]	xhahit2233@gmail.com

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Xhafer	Gashi	Drejtor	044-767-127	[Signature]	msusigjatos@hotmail.com
2	Elhami	Drumçi	-11-	044-267042	[Signature]	Elhami-dervishi@hotmail.com
3	Ramir	Behrovi	-1-	044-410-06	[Signature]	
4	Neki	SYLEJMANI	-1-	044/258894	[Signature]	sy/gues.w@iueksh.com
5	AZBI	GASHI	NËSIMONËNËS	049/143288	[Signature]	azbi.gashi@gmail.com
6	TEKI	MILSTAFI	ASISTENT	044-233172	[Signature]	tek.e-mail.com
7	NASER	DULA	DREJTOR	044-230279	[Signature]	naserdula@yahoo.com
8	MURAT	KRYEZI	KRYETAR	049-200772	[Signature]	murat-kryezi@hotmail.com
9	BRIKENA	OSA	DREJTOR	044-211	[Signature]	brikenosa@gmail.com
10	Qumaj	Dula	Pallodi		[Signature]	
11	Adem	Krasniqi	-1-	064/102	[Signature]	
12	Daut	Krasniqi	Kryetar	044/1358	[Signature]	
13	Siman	Bajraktari	Drejtor	044-356787	[Signature]	siman.bajraktari@hotmail.com
14	Daut	Krasniqi	Kryetar	044-777-19	[Signature]	daut.krasniqi@ksh.com
15	Bekim	Krasniqi	11 = 11	049/615-208	[Signature]	bekim.krasniqi@ksh.com
16	Idon	Krasniqi	Rektor	04662389	[Signature]	idon.krasniqi@ksh.com

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022 <i>Lista e zyrtarëve</i>
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Nora	Bashirpku	Drejtor	045-990615	<i>[Signature]</i>	nora.bashirpku@rks.gov.net
2	ERHAN	MORINA	DREJTOR	046/478-362	<i>[Signature]</i>	erhan.morina@rks.gov.net
3	AFRIM	DINA	DREJTOR	044/339035	<i>[Signature]</i>	afirm.dina@rks.gov.net
4	Alim	Limani	-/-	044/219-638	<i>[Signature]</i>	alim.limani@rks.gov.net
5	Arni	Morina	Drejtor	044/423 590	<i>[Signature]</i>	arni.g.morina@rks.gov.net
6	PERPARIM	KRASNIQI	-/-	044/315-261	<i>[Signature]</i>	perparim.krasniqi@rks.gov.net
7	AFRIM	GRUGI	-/-	045 134006	<i>[Signature]</i>	afirm.grugic@rks.gov.net
8	BERAT	DURAKU	-/-	045/134003	<i>[Signature]</i>	berat.duraku@rks.gov.net
9	KUTIM	DINA	-/-	049/465168	<i>[Signature]</i>	kutim.dina@rks.gov.net
10	Besnik	Hoti	an	049/333/454	<i>[Signature]</i>	besnik.hoti@rks.gov.net
11	Sorard	Sallik	-/-	045-134602	<i>[Signature]</i>	Sorard.Sallik@rks.gov.net
12	Fatmir	ISTO	Nënkryetar	044/293-155	<i>[Signature]</i>	fatmir.isto@rks.gov.net
13						
14						
15						
16						

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Sead	Raba	OSBE	049957314	<i>Sead</i>	sead.raba@osce.org
2	Astrit	Mulabajri	Z. Prillor	044/563-888	<i>Astrit</i>	astrit.mulabajri@rks-gov.me
3	Enise	Dina	Z. Prillor		<i>Enise</i>	enisedina1@gmail.com
4	ARBNOT	KUBUSHI	KADASTËR	044/914-142	<i>Arbnor</i>	arbnor.kubushi@rks-gov.me
5	Luqman	Fazlin	KOORDINT	045/648301	<i>Luqman</i>	luqmanfazlin@gmail.com
6	SHEDAT	UKAJ	K-S-12	044/748377	<i>Shedat</i>	shedat.ujak@rks-gov.me
7	<i>PRF</i>					
8	<i>ISMAEL</i>	<i>KORAJ</i>	<i>PRILLOR</i>	<i>044/128-837</i>	<i>Ismael</i>	<i>Ismaelkoraj@hotmail.com</i>
9	BESART	ZECA	KOORDINT	044/505500	<i>Besart</i>	besartzeca@hotmail.com
10	ISHAIZ	ZENA	QYTETAR	044/229882	<i>Ishai</i>	
11	Andion	Tomu	K. Rahov	044-229882	<i>Andion</i>	
12	Goni	HOTI	Informim	044/161438	<i>Goni</i>	
13	Ahmet	Lafeti	Informim	044/710-888	<i>Ahmet</i>	ahmet-18-2@hotmail.com
14						
15						
16						

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Elmi	Kronig	Drejtor	044-863-876		Elmi-kronig@e.ko
2	VALMIR	GASHI	ZYRTAR	044468118		
3	Antan	Therri	Qytetar	049-554-686		
4	Ruzhdi	Kashti	Qytetar	049-80-10-80		
5	AKRIT	BAJRI	Qytetar	045920-526		
6	STEFAN	DANA	ING.	045-884-310		stefan.dana@e.ko
7	DRILON	MUSTAFA	ARCH	049433-412		
8	Arben	MARKE	Qytetar	048-49-301		
9	Ilke	GASHI	Drejtor	044-203880		ilke-gashi@live.com
10	Liridon	BERISKA	Kordinator	049-489-513		liridon-beriska@photoim.com
11	Xherdet	MORRIS	Drejtor	044-861-850		xherdet_402@live.com
12	Halit	Sahitaj	Cjllake	044-140-023		halit.sahitaj@e.ko
13	Herim	SHARKU	Rahovec	044-204362		
14	Arsim	Kastrati	RKES	044-834474		arshim.kastrati@e.ko
15	Edita	HASHI	MEZVUCE	049-139009		edita.hashy@gmail.com
16	Sahadete	DULLA	Harre	044-204361		sahadete.dulla@gmail.com

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Begir	Mustafa	Koordin. i cilësive	044 204-236	[Signature]	
2	Jakir	Xhysco	Ingjiner	044 230-098	[Signature]	
3	Besa	Shola	RATNA	04469095	[Signature]	
4	Mustafa	HA	ROTOR C		[Signature]	
5	Mirsad	Qehaja	Kryetar	044255216	[Signature]	
6	SOKOL	THAQI	KOORDINATOR	044744049	[Signature]	
7	IZET	MORINA	Koordinator ERPK	048-676-198	[Signature]	
8	AGUESA	PAMADIANI	Zyrtar	041-929-488	[Signature]	
9	Drahman	Krasnigj	Pub. e le	044 641-307	[Signature]	
10	Djane	Durguti	Edukatore	045/309-85	[Signature]	
11	Besjana	Itoli	Edukatore	049-328 282	[Signature]	
12	Adelina	Pasovci	Ingjineri	044776193	[Signature]	adelina.shqkergja@utorail.co
13	Vanessa	Durguti	Mësuese	04936636	[Signature]	vanessadurguti@gmail.com
14	Almedina	Jaha	Psikologe	049-355-439	[Signature]	Almedina.Jaha123@gmail.com
15	Blerina	Hajda	Psikologe	045 982245	[Signature]	blerinahajda1992@gmail.com
16	Milaim	Alleti	Artist	044 424362	[Signature]	

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Melina	Krasniqi	SHL-K	01847522		gorgonimelina@gmail.com
2	Brenda	Rexha	Nxënëse	049209572		gjonclinger17@gmail.com
3	Erga	Gashi	Nxënëse	04545860		ericaagashi2@gmail.com
4	Era	Abdullahu	Nxënëse	049183753		era.abdullahu@gmail.com
5	Elona	Spahiu	Nxënëse	—		elona.spahiu05@gmail.com
6	Suela	Gashi	Nxënëse	044902533		Gashisuela22@gmail.com
7	Dina	Abdullahu	Nxënëse	044638646		dinibrahimi96@gmail.com
8	Enblin Fazli	Fazli	Nxënëse	043802607		EnblinFazli13@gmail.com
9	Selda	Gashi	Nxënëse	044902533		Gashisuela22@gmail.com
10	Fjolla	Hoti	Nxënëse	045354736		Fjollahoti2004@gmail.com
11	Oriental	Duraku	Nxënëse	043548345		Orientalduraku@gmail.com
12	Fjolla	Zenuni	Nxënëse	04350338		Fjollazenuni3@gmail.com
13	Dion	Gashi	Nxënëse	045968845		—
14	Aurora	Gashi	Nxënëse	049144035		auroragashi99@gmail.com
15	Elekina	Monina	Nxënëse	049330054		elekina.monina1@gmail.com
16	Parid	Cena	Nxënëse	049630408		paridcena.1@outlook.com

Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Zyra për Informim



Lista e qytetarëve-Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë
mujorin e parë të vitit kalendarik 2022

Data	23/06/2022
Tema	Takimi i parë publik me qytetarë për punën e qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik 2022
Vendi	Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal
Ora	13:00

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi	Emaili
1	Bajti	Nazifi	Vullnetar	045-44787	[Signature]	bajtinazifi@gmail.com
2	Valentina	Kneoniti	Vullnetar	04919192	[Signature]	Valentina.kneoniti@gmail.com
3	Anisa	Xhasnugi	Vullnetar	043-875328	[Signature]	
4	Polta S.	Gjurgole	SHL-K	049/452-453	[Signature]	poltagjurgole@GMAIL.com
5	Sikumbin	ADIFI	-U-	049/86-799	[Signature]	
6	BESNIK	ORCQI	[Signature]	04930150	[Signature]	BESNIK ORCQI@gmail.com
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						


Zyrtari Komunal: _____

Nënshkrimi : _____

Data: 22/06/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, nenit 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna dhe nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën:

NJOFTIMIN

PËR

TAKIMIN E PARË PUBLIK TË KRYETARIT

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi organizon takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2022.


Takimi publik me qytetarë do të mbahet më datë: 23.06.2022 (e enjte), në orën 13:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec. Në këtë takim do të keni mundësi të njiheni për punën e qeverisë komunale në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2022 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Po ashtu qytetarët pjesëmarrës në takim mund t'i bëjnë pyetje dhe komente ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre ju interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datë: 22.06.2022 në ora 16:00, në emailat: ali.morina@rks-gov.net dhe blerta.gashi@rks-gov.net.

Jeni të mirëpritur!





Na osnovu člana 68. stav 1 Zakona za Lokalnu Samoupravu Br. 03/L-040, na osnovu člana 23 i člana 24 Statuta Opštine Orahovac Br. 1005 od 29.03.2017, člana 10 tačka 1 i 2 Administrativnog Uputstva (MALS) Br. 03/2020 za transparentnost opština i člana 7 Opštinskog Pravilnika za Transparentnost Br. 03/2020, Kancelarija za Informisanje donos:

OBAVEŠTENJE

za

JAVNI SASTANAK PREDSEDNIKA

Obaveštavamo sve građane opštine Orahovac, interesne grupe i ostale zainteresovane stranke, da Predsednik opštine Orahovac, g. Smajl Latifi organizuje prvi javni sastanka sa građanima za njegov prvi šestomesečni rad za 2022. godinu.

Javni sastanka sa građanima održaće se: 23.06.2022 (četvrtak), sa početkom u 13:00, u sali Skupštine Opštine Orahovac. Na ovom sastanku će te imati priliku da se informišete o radu opštinske vlade za prvo šestomesečje 2022. godine i trenutnih dešavanja opštine.

Takođe građani učesnici na ovom sastanku mogu da postave pitanja i komentare opštinskoj izvršnoj vlasti za sve teme koje ih zanimaju.

Komentari, sugestije i sugestije dostupni su 22. juna 2022. godine u 16:00 časova, na e-mail: ali.morina@rks-gov.net i blerta.gashi@rks-gov.net.

Dobro došli!

Kancelarija za Informisanje

